VENDIM
Nr. 43, datë 7.4.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "PHOENIX PETROLEUM" SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, "Për sektorin e gazit natyror", neni 14, pika 1, germa "ç", si dhe neni 4, pika 1, germa "ç"; neni 8, neni 9 pika 1, germa "a", "b", "c", "d"; pika 2, germa "a" dhe nenin 10, të "Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.4.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Phoenix Petroleum" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Phoenix Petroleum" sh.a., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie plotëson pjesërisht kërkesat e ligjit si më poshtë vijon:

- Neni 9, pika 1, germa "a"
- Tipi i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 1, germa "b" është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 1, germa "c" është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale, plotësuar pjesërisht.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës, plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të neni 10, të "Rregullat dhe procedurat për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror", miratuar me vendimin nr. 9 datë 11.2.2011 të ERE-s, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqerisë "Phoenix Petroleum" sh.a., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror me shumicë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti